



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1080/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 45 studentë për vit akademik;*
 2. *Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
- II. Akreditohet programi i studimit i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 1. *Dizajn Softueri, Baçelor profesional 180 ECTS, me kuotën maksimumi 180 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I dhe II zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc 120 ECTS;</i>	Esma Canhasi Ajka Aljiji
2.	<i>Dizajn Softueri, Baçelor profesional 180 ECTS;</i>	Arta Misini Arbër Beshiri Betim Maloku
3.	<i>Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit, BSc 180 ECTS;</i>	Faruk Bojaxhi Yll Kortoçi Albana Milaimi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc 120 ECTS***, më 26.03.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peeter Normak, Miklos Hoffmann dhe Issabek Muratov, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) ndërsa Substancialisht gjashtë (6).
- Për programin e studimit; *Dizajn Softueri, Baçelor Profesional 180 ECTS***, më 26.03.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peeter Normak, Miklos Hoffmann dhe Issabek Muratov, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) ndërsa Substancialisht gjashtë (6).
- Për programin e studimit; *Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit, BSc 180 ECTS***, më 04.04.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joachim Muller dhe Hans Peter Kaul dhe Katerina Klimoska, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) ndërsa Substancialisht katër (4).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 20.05.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë